

UNMIK



Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

Komunikatë
e përbashkët për media

www.unmikonline.org



COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

UNMIK/PR/1360
E hënë, 9 maj 2005

PSSP përshëndet takimin inaugures të komisionit zbatues për rindërtimin e monumenteve fetare

PRISHTINË – PSSP Søren Jessen-Petersen përshëndeti takimin inaugures të komisionit zbatues për rindërtimin e monumenteve fetare që u mbajt sot në mëngjes në zyrën e Këshillit të Evropës (KE) në Prishtinë. Takimi i komisionit zbatues pason pas nënshkrimit, në mars 2005, të memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet patrikut të kishës ortodokse serbe dhe ministrit të Kulturës (IPVQ).

“Kjo është shenjë shumë pozitive se procesi tani po shkon përpara dhe po e hap rrugën në mënyrë që puna e vërtetë e rindërtimit të fillojë së shpejti,” tha PSSP.

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Astrit Haraqija, konfirmoi se 4.2 milionët eurot e ndara nga IPVQ-ja për rindërtimin e vendeve të dëmtuara në trazirat e marsit 2004 kanë qenë në dispozicion, duke shtuar se planifikonte t’i siguronte edhe 1.5 milionë euro të tjera për procesin e rindërtimit.

Përfaqësuesi i sinodit të shenjtë, peshkopi Teodosije, tha se nënshkrimi i MiM-it ishte hap i madh përpara, pasi vonesat gjatë vitit të kaluar treguan se pati keqësim të mëtejshëm të monumenteve. Peshkopi Teodosije vuri në pah se shumë monumente janë pjesë e trashëgimisë kulturore evropiane dhe botërore dhe, ndonëse ato janë pronë e kishës ortodokse serbe, ato u takojnë të gjithë popujve të Kosovës.

Gjatë këtij takimi, KE dhe Komisioni Evropian konfirmuan caktimin e ekspertës ndërkombëtare për trashëgimi, Emma Carmichael, si kryetare të komisionit zbatues. Në këtë komision, IPVQ-në do ta përfaqësojnë Njazi Haliti dhe Osman Gojani, zyrtarë të Ministrisë së Kulturës, dhe qeverinë serbe do ta përfaqësojë Dragolub Todoroviq.

KE do ta financojë një grup të ekspertëve ndërkombëtarë, të cilët do të ofrojnë ndihmë teknike.

Në këtë takim, përfaqësuesi i UNMIK-ut përsëriti mbështetjen e plotë të PSSP-së për procesin e rindërtimit dhe theksoi faktin se UNMIK-u do të vazhdojë të angazhohet në mënyrë aktive në këtë proces.